



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Istogut**  
Skupstina Opstine  
Municipal Istog

---

**Drejtoria Komunale e Arsimit**

05.Nr.312/22  
Dt.06.05.2022

Duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 35 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 5 pika e e Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të zv.drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo –Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimet ,Përfundimit të Kontratës dhe Emërimet e Përkohshme , Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, shpall:

**KONKURS**

**I. Titulli i vendit të punës; Drejtor i Gjimnazit “Haxhi Zeka” në Istog**

Institucioni: **Komuna e Istogut**

Departamenti/Drejtoria: **Drejtoria Komunale e Arsimit**

Lloji i pozitës: **Jo i karrierës**

Numri i pozitave: **1 (një) pozitë**

Titulli i mbikëqyrësit: **Drejtori i Arsimit**

Grada/Koeficienti: **- 8.4**

Orët e punës: **40 orë**

Kohëzgjatja e emërimit: **4 (katër) vite**

**Qëllimi i vendit të punës:**

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

**Detyrat Kryesore:**

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës.
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi.
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit.

- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës.
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtoreve profesional të institucionin edukativo-arsimore.
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucioneve edukativo –arsimore (KDSH) Këshillin e Prindërve Këshillin e Arsimitareve, Këshillin e Nxënësve dhe Komunitetin e institucionin edukativo-arsimore.
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH.
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimore duke përfshire edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve sipas legjislacionit në fuqi.
- Bënë ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsimin parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

#### **Kushtet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Të jenë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi.
- 1.Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsimit (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar),  
2.Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite shkollim universitar),  
3.Katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar)  
4.Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar),  
Të ketë licencës të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve,
- Të ketë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë të aprovuara nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo – arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës,  
1.Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë,  
2.Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët në nivele tjera,  
3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zv.drejtor.

### **Dokumentet e nevojshme që kërkohen:**

1. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit e vërtetuar të **Noteri**
2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje ,administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Mastër për Udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve.
3. Kopja e dokumentit të identitetit (ID)
4. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion shëndetësor i licencuar më të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.
5. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krime dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët.
6. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimorë.
7. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë më asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
7. Profolon profesionale me dëshmi sipas udhëzuesve në shtojcën /formularin H të këtij UA.
8. Certifikatën e lindjes.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 06.06.2022 deri më datë 21.06.2022**

**Kandidatët e interesuar i marrin formularët e kërkesave në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në hyrje të ndërtesës së Komunës zyra Nr.100.  
Kërkesën bashkë me dokumentacion të nevojshëm e dorëzojnë në të njejtën zyrë.**

**Vërejtje:** Dokumentat e pakompletuara dhe ato të arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drejtori i DKA-së  
Faim Behlulaj

